

Ne perputhje me Nenin 28 paragrafi 3 i Ligjit 9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" ky dokument perben:

**AKTI I THEMELIMIT
DHE**

STATUTI

I

SHOQERISE

"Bio Alpina" SHPK

Sot, me date 25 Tetor 2022, ne Tirane, une,

- **Z. Irgent Myftaraj**, shtetase shqiptare, i biri i Ibrahimit, lindur me 01.02.1984, ne Kukes banues ne adresen Tom Plezha, Njesia Administrative Nr. 14, Tirane, mbajtes i Kartes se Identitetit me Nr. 034886756 dhe Nr. Personal I40201056O, madhor me zotesi te plete juridike per te vepruar;

vendosa te nenshkruale kete Akt Themelimi dhe Statutin e meposhtem per krijimin e nje shoqerie me perqejesi te kufizuar, aktiviteti i se ciles rregullohet nga legjislacioni shqiptar ne fuqi dhe Statuti i meposhtem.

AKTI I THEMELIMIT

DHE

STATUTI I SHOQERISE (“*Statuti*”)

**Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar
"BIO ALPINA" SHPK
("Shoqeria")**

Neni 1 **Emri i Shoqerise dhe Forma Ligjore**

- 1.1 Ne baze e ne perputhje me legjislacionin ne fuqi ne Republiken e Shqiperise, themelohet Shoqeria "Bio Alpina"
- 1.2 **Bio Alpina** SHPK e ndjekur ne menyre te pandashme nga shkurtimi "SHPK" e cila perfaqeson formen juridike te saj, te ciles ketej e tutje do t'i referohemi shkurtimisht si "**Shoqeria**".
- 1.2 Shoqeria eshte nje person juridik Shqiptar, qe ka formen ligjore te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar, ne perputhje me Ligjin Nr. 9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" ("*Ligji per Shoqerite*").
- 1.3 Shoqeria fiton personalitet juridik nga momenti i regjistrimit te saj ne Qendren Kombetare te Biznesit ("**QKB**"), ne perputhje me legjislacionin Shqiptar.
- 1.4 Ortaket e Shoqerise gezojne pergjegjesi te kufizuar deri ne kufirin e kontributeve perkatese te tyre ne kapitalin e perfaquesuar ne kuota.
- 1.5 Ne çdo dokument, fatura, shpallje apo publikime te bera nga Shoqeria, pavaresisht nga menyra e transmetimit, emri i Shoqerise duhet te shoqerohet ose te ndiqet nga:
 - a. Fjalet "Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar" ose "SHPK";
 - b. Numri unik i identifimit (NIPT);
 - c. Seline e regjistruar dhe zyren qendore; dhe
 - d. Te dhena nese Shoqeria eshte ne proces likujdimi.

Neni 2

Selia

Ne momentin e miratimit te ketij Statuti, Selia e Shoqerise ndodhet ne adresen me numer pasurie 298/212+1-N10, zona kadastrale 3866, te ndodhur ne adresen Rruga "Tom Plezha", Yzberish Tirane, Shqiperi. Shoqeria me vendim te Asamblese se Pergjithshme mund te zhvendose seline e saj ose te krijoje nje qender operative ne nje vend tjeter ne Republiken e Shqiperise. Shoqeria mund te hape dege ose zyra perfaqesimi ne çdo vend brenda ose jashte Republike se Shqiperise, sipas gjykimit te Asamblese se Pergjithshme.

Neni 3

Objekti i Shoqerise

3.1 Objekti i aktivitetit te Shoqerise eshte:

- i. Eksport Import tregtim perpunim dhe ambalazhim :
 - bime medicinale cajra ereze vajra bimore produkte ushqimore
 - agroushqimore te fresketa dhe te ngrira;
 - artikuj kozumeike parfumeri kancelari konfeksione ;
 - paisje industriale, makinri automjete etj.
- ii. Te gjithe aktivitetet e tjera te cilat lejohen nga ligji shqiptar.

Gjithashtu, ne perputhje me legjislacionin Shqiptar, Shoqeria mund te kryeje dhe realizoje çdo aktivitet qe lidhet direkt ose indirekt, qe eshte pasoje e, apo e lidhur me, aktivitetet e listuara me lart. Per te arritur qellimin e mesiperm, Shoqeria mund te ndermanre çdo aktivitet dhe sherbim qofte tregtar, finanziar, per dhenie e marrje me qira, apo hipotekim, qe mund te konsiderohet i dobishem apo i nevojshem ne menyre qe te realizohet objekti i Shoqerise.

3.2 Shoqeria mund te ndermanre çdo aktivitet qe eshte ne perputhje me objektin e veprimtarise se saj, i lidhur me te dhe ne interes te saj.

3.3 Shoqeria mund te krijoje apo te marre pjese ne shoqeri, sipermarrje te perbashketa, partneritete dhe te gjitha format e bashkepunimi, brenda qellimit dhe objektivave te saj.

3.4 Shoqeria duhet te zbatoje te gjitha ligjet dhe rregulloret perkatese. Ajo duhet t'i permbahet standardeve me te mira etike.

3.5 Shoqeria ka te drejten te beje ndryshime te objektit te aktivitetit te saj ne çdo kohe siç parashikohet ne kete Statut.

Neni 4 **Kohezgjatja e Shoquerise**

Kohezgjatja e Shoquerise eshte per nje periudhe te pacaktuar.

Neni 5 **Ortaket**

Ne momentin e miratimit te ketij Statuti, ortaki vetem i Shoquerise eshte :

- Z Irgent Myftaraj.

Neni 6 **Kapitai i Regjistruar dhe Kuotat**

6.1 Kapitali i regjistruar dhe i paguar i Shoquerise eshte 100.000 (njeqindmije) Leke dhe eshte plotesisht i nenshkruar dhe i shlyer.

6.2 Kapitali i Shoquerise perbehet nga nje kuote te cilat zoterhen nga:

- Z. Irgent Myftaraj dhe perfaqeson 100% te kapitalit;

6.3 Shoqeria mund te vendose ne deskpcionin e saj nese do te jete e nevojshme, per mbajtjen e Librit te Ortakeve, nen kujdesin e Administratorit/eve, me qellimin per te reflektuar çdo te drejte te Ortakeve apo te drejte te paleve te treta mbi kuotat e Shoquerise ("Libri i Ortakeve"). Libri i Ortakeve do te permbate keto informacione:

- (i) vleren e kuotave te zoteruara nga Ortaket;
- (ii) diten kur Ortaku/et ka/kane fituar pronesine mbi kuoten;
- (iii) emrin dhe adresen apo seline e Ortakut/eve;
- (iv) vleren e kuotes perkatese te zoteruar nga secili Ortak; dhe
- (v) te dhena mbi çdo peng, barresim ose çdo te drejte tjeter reale mbi kuoten. Ortaku/et ka/kane te drejte, me ane te kerkeses me shkrim te kerkoje/ne nje ekstrakt te Librit te Ortakeve me vulen e Shoquerise. Ortaku/et ka/kane te drejten te verifikoje/ne regjistrimin ne Librin e Ortakeve dhe Administratori/et nese kerkohet me shkrim, duhet te siguroje/ne asistencen e nevojshme per Ortakun/et.

6.4 Pronesia mbi kuoten i jep zoteruesit te saj te drejtat dhe detyrimet sic parashikohen ne Ligjin per Shoqerite. Te drejtat dhe detyrimet qe rezultojne nga pronesia mbi kuoten jane te transferueshme ne çdo zoterues te ri te kesaj kuote.

Neni 7

Zmadhimi dhe Zvogelimi i Kapitalit

7.1 Asambleja e Pergjithshme mund te vendose te zmadhojne ose te zvogelojne kapitalin e regjistruar te Shoquerise ne çdo kohe ne perputhje me nenet e ketij Statuti dhe ne perputhje me Ligjin per Shoqerite.

7.2 Shoqeria ka te drejten te bleje ose te anulloje kuotat e saj si resultat i zvogelimit te kapitalit te regjistruar.

7.3 Kapitali i regjistruar mund te rritet nepermjet kontributeve ne para ose kontributeve ne natyre, permes perfshirjes ne te te rezervave ose fitimeve apo dhe permes konvertimit te borxheve ne kuota kapitali.

7.4 Zmadhimi i kapitalit te Shoquerise mund te kryhet permes sigurimit te kuotave te reja ose rritjes te vleres nominale te kuotes ekzistuese. Kuotat duhet te registrohen dhe vlera e tyre nominale duhet te paguhet plotesisht.

7.5 Zmadhimi i kapitalit nuk do te dobesoje pjeset e interesit te Ortakeve ne Kapitalin e Shoquerise, pervecse kur Ortaket do te bien dakord ndryshe me vendim unanim te Ortakeve.

Neni 8

Te drejtat dhe detyrimet e Ortakeve

8.1 Ortaket jane vetem ata te cilet zoterojne kuotat e Shoquerise.

8.2 Çdo Ortak do te kete te drejta vote ne Asamblene e Pergjithshme te Ortakeve ("Asambleja e Pergjithshme") ne perpjestim me vleren nominale te kuotes qe zoteron. Çdo Ortak ka te drejten per te zgjedhur dhe per t'u zgjedhur ne organet drejtuese, te drejten per te marre pjese ne shperndarjen e fitimeve te Shoquerise, sikunder te drejtat e parashikuara nga ky Statut, per çdo marreveshje te detyrueshme ndermjet Ortakeve dhe dispozitave ligjore te Ligjit te Shoqerive.

8.3 Ortakeve do t'u jepen, me kerkese me shkrim, informacione dhe te dhena ne lidhje me aktivitetin e Shoqerise ne çdo kohe, duke perfshire te drejten qe te kontrollojn dokumentat dhe raportet e Shoqerise.

8.4 Te drejtat dhe detyrimet qe rezultojne nga zoterimi i Kuotave, transferohen tek çdo zoterues i ri per keto Kuota.

8.5 Detyrimet e Shoqerise jane te garantuara nga kapitali i saj, dhe Ortaket mundet vetem te mbajne perjegjesi brenda limitit te vleres se kuotave qe ata zoterojne. Ortaket nuk mbajne perjegjesi qe tejkalojne investimin e tyre perkatesisht ne kapitalin e Shoqerise.

8.6 Shoqeria nuk mban perjegjesi per borxhe ose detyrime te tjera te Ortakeve te saj.

Neni 9

Transferimi i pjeseve te Kapitalit

9.1 Pjeset e kapitalit transferohen lirisht midis Ortakeve.

9.2 Ortaket mund t'i ndajne kuotat e tyre me qellimin e transferimit te pjeseve te ketyre kuotave ne perputhje me Ligjin per Shoquerite.

9.3 Ne rast se nje Ortak do te shese, transferoje, ose perdore ne menyra te ndryshme pjese apo te gjithe kuoten e tij, Ortaku tjeter do te kete te drejten e parablerjes, kundrejt bleresve te tjere. Nese Ortaku me te drejte parablerejeje do te kete bere nje oferte dhe kjo oferte eshte refuzuar nga Ortaku qe shet, atehere Ortaku qe shet nuk do te kete te drejte t'i shesi kuoten tek nje bleres tjeter me cmim me te ulet se cmimi i ofruar nga Ortaku i preferuar.

9.4 Çdo transferim i kuotave do te behet ne perputhje me dispozitat e Ligjit te Shoquerive dhe duhet te regjistrohet prane Qendres Kombetare te Biznesit.

Neni 10

Drejtimi dhe Organizimi i Shoqerise

Drejtimi i Shoqerise eshte i ndare ndermjet:

- a. Asamblese se Pergjithshme, dhe
- b. Administratorit/administratoret.

Neni 11

Asambleja e Pergjithshme

11.1 Asambleja e Pergjithshme eshte organi me i larte i vendimmarjes ne Shoqeri.

11.2 Asambleja e Pergjithshme zoteron te drejten e plete te vendose ne lidhje me çeshtjet e meposhtme:

- a. Percaktimin e politikave investuese dhe tregtare te Shoqerise.
- b. Ndryshimin e Statutit dhe te formes ligjore te Shoqerise.
- c. Emerimin dhe shkarkimin e Administratorit/eve dhe miratimin e planit te shperblimeve te tyre.
- d. Emerimin dhe shkarkimin e likuidatoreve, eksperteve kontabel dhe audituesve te pavarur, si dhe miratimin e planit te shperblimeve te tyre.
- e. Mbikqyrjen nepermjet Administratorit/eve te zbatimit te politikave tregtare, perfshire perqatitjen e pasqyrave financiare vjetore si dhe raportit te ecurise se veprimtarise.
- f. Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve te ecurise se veprimtarise.
- g. Zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit.
- h. Shperndarjen e te ardhurave, fitimeve, dividenteve dhe mbulimin e humbjeve.
- i. Ndarjen, pjesetimin e kuotes dhe anulimin e saj.
- j. Perfaqesimin e Shoqerise ne gjykate dhe ne procedime te tjera kundrejt Administratorit/eve.
- k. Themelimin e shoqerise dhe degeve te saj.
- l. Mosaplikimin e nenit 17 te Ligjit per Shoqerite per ndalimin e konkurencës.
- m. Ristrukturimin, shperndarjen, shkrirjen ose falimentimin e Shoqerise.
- n. Çeshtje te tjera qe kane te bejne me kerkesat ligjore te nenit 13 dhe 82 te Ligjit per Shoqerite.
- o. Ndryshimin e objektit te Shoqerise ose perfshirjen e çeshtjeve te tjera qe jane jashtë objektit dhe qellimit te Shoqerise ne aktivitetin kryesor te Shoqerise.
- p. Shitjen/kalimin, ose dhurimin ndaj personave te trete te çdo lloj pjesë te Shoqerise, perfshire transferimin apo blerjen e çdo kuote te Shoqerise nga apo per palet e treta.
- q. Ndryshimin e struktura e te pjesave te kuotes se Shoqerise, gjetjen e ortakeve te tjere, te bashkohet me shoqeri te tjera tregtare, te krijoje

partneritet duke shitur pjesë te kuotes, te percaktoje shperndarjen e te ardhurave, te krijoje partneritete strategjike.

- r. Nenshkrimin e kontratave te franchising, nenkontraktuale dhe te drejtes se distributorit.
- s. Shoqeria mund te shese ose te jape per perdorim çdo te drejtë qe zoteron per perdorimin e markes, licences dhe patentes se saj si dhe t'i jape personave te trete te drejten e perdorimit te markes tregtare te saj.
- t. Vendosjen e aseteve te Shoqerise si garanci.
- u. Blerjen apo marrjen me qira te pronave te paluajtshme ne emer te Shoqerise, ose shitjen e pronave te paluajtshme te Shoqerise, lenien peng te mallrave te Shoqerise si garanci ndaj personave te trete, si dhe vendosjen e te drejtave kufizuese mbi mallrat e Shoqerise.
- v. Emetimin e kuotave te reja, letrave te debitit dhe instrumentave tregtare.
- w. Si dhe per çeshtje te tjera qe percakton Ligj per Shoqerite.

11.3 Asambleja e Pergjithshme duhet te mblidhet te pakten 1 here ne vit.

11.4 Asambleja e Pergjithshme mund te thirret per te vodosur per çeshtjet e meposhtme, si nje kerkese e detyrueshme e nenit 82 te Ligjit per Shoqerite;

- a. kur sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare rezulton rreziku qe aktivet e Shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 mujave ne vazhdim.
- b. kur eshte nje propozim per te shitur apo per te disponuar ne menyre tjeter aktive asete te cilat kane nje vlere me te larte se 5% te aseteve te Shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

11.5 Ne perputhje me nenin 92 te Ligjit per Shoqerite, Asambleja e Pergjithshme mund t'i kerkoje gjykates perkatese anulimin e vendimeve te Administratorit/eve, kur keto perbejne shkelje te rende te Statutit apo te Ligjit per Shoqerite.

11.6 Obligacionet e Shoqerise jane te garantuara permes kapitalit e saj, dhe Ortaket kane pergjegjesi deri ne vleren e koutave te mbajtura prej tyre. Ortaket nuk kane pergjegjesi ne kalimin e investimeve te tyre ne kapitalin e Shoqerise (me perjashtim te huave dhe garancive).

Neni 12
Menyra e Thirrjes se Mbledhjeve

12.1 Asambleja e Pergjithshme thirret te vendose per çeshtjet e shtruara perpara saj nepermjet thirrjes se mbledhjeve ose nepermjet konsultave me shkrim.

12.2 Asambleja e pergjithshme mund te thirret nga nje prej Administratoreve ose nga çdonjeri prej Ortakeve.

12.3 Asambleja e Pergjithshme mblidhet ne seline e Shoqerise, ne seline e nje dege te saj, apo ne çdo qytet apo province te botes siç bihet dakord midis Ortakeve. Vendi i zgjedhur, data dhe ora e ketyre takimeve si dhe rendi i dites perkates i mbledhjeve u njoftohet Ortakeve te pakten 7 dite para mbledhjes. Ne rast se Asambleja e Pergjithshme nuk eshte thirrur ne perputhje me kerkesat e ketij paragrafi, kjo e fundit mund te marre vendime te vlefshme vetem ne rast se te gjithe Ortaket bien dakort.

12.4 Administratori/et duhet te sigurojne qe njoftimi i Asambleja e Pergjithshme eshte bere ne perputhje me formen dhe permajtjen e nenit 83 te Ligjit per Shoquerite. Mospermbyshja e formaliteteve te njoftimit i ben vendimet e Asambleja se Pergjithshme te pavlefshme, me perjashtim te rastit kur Asambleja e Pergjithshme njeh dhe pranon parregullsite, deri ne masen e lejuar nga ligji.

12.5 Secili prej Ortakeve gezon te drejten te perfaqesohet nga nje person tjeter ne perputhje me nenin 85 te Ligjit te Shoqerive.

Neni 13

Procesi i Vendimmarries se Asamblese se Pergjithshme

13.1 Asambleja e Pergjithshme mund te marre vendime ne mbledhjet e thirrura ose ne forme te shkruar, ne çdo rast kur konsiderohet ne te mire te Shoqerise.

13.2 Ne rast se Asambleja e Pergjithshme do te marre vendim ne formen e shkruar, Administratori/et do t'i dergoje/ne Ortakut/eve tekstin e vendimit te propozuar se bashku me dokumentacionin qe mbeshtet vendimi me poste, faks apo me mjete elektronike te sigurta te pakten 7 (shtate) dite para dates se propozuar per mbledhjen e asamblese. Asambleja e Pergjithshme duhet te miratoje dhe te ktheje vendimin brenda 15 (pesembedhjete) diteve nga data e dergimit tek Ortaku/et te vendimit me shkrim. Asambleja e Pergjithshme

miraton vendimin duke kthyer nje kopje te firmosur te vendimit te shkruar tek Administratori/et ne seline e Shoqerise.

13.3 Vendimet e Asamblese se Pergjithshme te hartuara ne perputhje me Ligjin per Shoquerite dhe kete Statut do te kene fuqi detyruese per Shoquerine. Vendime te tilla mund te merren edhe jashte Republikes se Shqiperise dhe evidenca me shkrim e ketij vendimi duhet t'i dorezohet Administratorit/eve i cili/te cilet duhet t'i regjistroje/ne ne Regjistrin e Vendimeve te Asambleja e Pergjithshme.

13.5 Ne rastet ku kerkohet nga ligji, disa vendime te Asamblese se Pergjithshme duhet te noterizohen nga nje noter publik Shqiptar. Nese keto vendime jane marre jashte Republikes se Shqiperise, ato duhet te hartohen ne perputhje me ligjin Shqiptar per njohjen e dokumentave te huaja ne Republiken e Shqiperise (p.sh procedurat e apostilimit apo superegalizimit sipas vendit te marrjes se vendimit).

13.5 Te gjitha vendimet e Asambleja e Pergjithshme duhet te regjistrohen ne procesverbal dhe ne regjistrin e vendimeve te Asamblese se Pergjithshme te mbajtur ne kujdesin e Administratorit/eve dhe ne perputje me nenin 90 te Ligjit per Shoquerite ("Regjistri i Vendimeve te Asamblese se Pergjithshme"). Te dhenat e hedhura ne kete regjister nuk mund te tjetersohen apo te ndryshohen.

Neni 14 Administratori/et

14.1 Shoqeria administrohet nga nje ose me shume Administratore.

14.2 Ne momentin e miratimit te ketij Statuti, Administrator i Shoqerise eshte: Znj. Anxhesila Myftaraj, shtetas shqiptar, e bija e Hybiut, lindur me 03.01.1987, ne Fier, banues ne adresen Rr. "Tom Plezha", Tirane, Njesia Administrative Nr. 14, Tirane, mbajtes i Kartes se Identitetit me Nr. 031849742 dhe Nr. Personal I75103042S.

Afati i emerimit i Administratorit fillon me date 26.10.2022 dhe perfundon me 26.10.2027.

Specimeni i nenshkrimit te Administratorit *Anxhesila Myftaraj* 
14.3 Asambleja e Pergjithshme mund te ndryshoje ne çdo kohe nese e konsideron te nevojshme numrin e administratoreve.

14.4 Administratori/et mund te jene te çdo shtetesie dhe emerohen per nje periudhe jo me te gjate se 5 (pese) vjet me te drejte riemerimi.

14.5 Sipas nenit 95 te Ligjit per Shoqerite dhe nenit 13 te po ketij ligji, i cili citon kushtet e kualifikimit, administratori i nje shoqerie mëme nuk mund te emerohet si administrator te nje shoqerie te kontrolluar dhe anasjelltas.

14.6 Ne rastet e vdekjes, doreheqjes, largimit, apo diskualifikimit te çdo Administratori, zevenduesi i tij duhet te emerohet me vendim te Asamblese se Pergjithshme.

14.7 Asambleja e Pergjithshme ka te drejten te largoje nga detyra çdo Administrator me vendim te shkruar.

14.8 Administratori/et pranon/jne qe marredhenia e tij/tyre me Shoqerine bazohet ne mirebesim; ne kete menyre vendimi i Asamblese se Pergjithshme per te larguar administratoret konsiderohet nje arsye legitime, ne baze te legjislacionit te zbatueshem.

14.9 Ne rastet kur per lidhjen, ndryshimin dhe zgjidhjen e transaksionit (transaksioneve)/ kontrates (kontratave) kerkohet nje marreveshje e perbashket e Administratorit/eve dhe nje marreveshje e tille nuk arrihet çeshtja do t'i referohet Asamblese ee Pergjithshme e cila do te zgjidhe çeshtjen me vendim.

14.10 Asambleja e Pergjithshme mund te miratoje vendimin i cili i jep te drejten Administratorit/eve qe te perfaqesoje/ne te gjithe bashke ose individualisht dhe/ose te drejten per te kryer disa transaksione.

14.11 Administratori/et duhet te kryeje/ne ne çdo kohe ato veprime te kerkuara nga Asambleja e Pergjithshme ne perputhje me kete Statut dhe ligj.

14.12 Administratori/et mund te hapin llogari bankare dhe te kryejne veprime bankare me firme te vetme.

14.13 Shoqeria duhet te rimbursoje Administratorin/et per shpenzimet e udhetimeve te arsyeshme te lidhura me prezencen e Administratorit/eve ne nje vend jashte vendbanimit te Administratorit/eve si dhe shpenzime te tjera te bera nga Administratori/et ne te mire te Shoqerise, vetem nese ky rimbursim eshte bere pjesa e shperblimit te te njejtës.

Neni 15
Te drejtat e Administratorit/eve

15.1 Administratori/et eshte/jane perjegjes per drejtimin dhe perfaqesimin e Shoqerise.

15.2 Ne vecanti Administratori/et ka/kane te drejten dhe detyrimin per te vendosur personalisht dhe/ose bashkerisht si dhe te perfaqesoje Shoqerine ne:

- a. drejtimin e biznesit te Shoqerise duke zbatuar politikat tregtare te krijuara nga Asambleja e Pergjithshme.
- b. perfaqesojne Shoqerine.
- c. kujdesen per mirembajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe librave te kontabilitetit te Shoqerise.
- d. pergatisin dhe nenshkruaje bilancin vjetor dhe bilancet e konsoliduara si dhe raportet e ecurise se veprimtarise dhe i paraqesin keto dokumente per miratim te Asambleja e Pergjithshme bashke me propozimin per shperndarjen e fitimeve.
- e. krijimin e nje sistemi paralajmerimi ne kohen e duhur ne lidhje me rrrethanat qe kercenojne ekzistencen e Shoqerise.
- f. raportimin tek Asambleja e Pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe realizimin e veprimeve te nje rendesie te vecante per veprimtarine e Shoqerise.
- g. lidhjen e çdo kontrate apo ndermarrjen e çdo veprimi apo transaksi.
- h. thirrjen per vendimet e Asamblese se Pergjithshme ne rastet e paraqitura ne Nenin 82, paragrafet 3 deri ne 5 te Ligjit per Shoqerite;
- i. kryejrjen e detyrave te tjera te caktuara nga ligji apo Asambleja e Pergjithshme;
- j. kryejrjen e regjistrimeve dhe dergimin e te dhenave te Shoqerise prane Qendres Kombetare te Biznesit, kur eshte e nevojshme.
- k. autorizimin e nje ose disa personave te tjere per te kryer detyrat e Administratorit.

Neni 16
Detyrimi i Besnikerise dhe Pergjegjesia e Administratorit/eve

16.1 Sipas detyrave ne mirebesim te paraqitura ne Nenet 14, 15, 17 dhe 18 te Ligjit per Shoqerite, Administratori/et duhet te:

- a. te kryejne detyrat e tyre te percaktuara nga ligji apo ky Statut ne mirebesim dhe ne interes te Shoqerise, duke i kushtuar vemendje te vecante ndikimit te veprimtarise se Shoqerise ne mjedis;

- b. te ushtrojne qe u njihen me ligj apo nga ky Statut, vetem per arritjen e qellimeve te percaktuara ne keto dispozita;
- c. te vleresojne me pergjegjesi çeshtjet per te cilat merret vendim;
- d. te prandalojne dhe menjanojne rastet e konfliktit, prezent apo te mundshem, te interesave personale me ato te Shoqerise;
- e. te garantoje miratimin e marreevshjeve sipas dispozitave te pikes 3 te Nenit 13 te Ligji per Shoqerite;
- f. te ushtrojne detyrat e tyre me profesionalizem dhe kujdesin e nevojshem.

16.2 Administratori/et gjate kryerjes se detyrave per gjigjet/n kundrejt Shoqerise per çdo veprim ose mosveprim qe lidhet ne menyre te arsyeshme me qellimet e Shoqerise, me perjashtim te rasteve kur ne baze te hetimit dhe vleresimit te informacioneve perkatese, veprimi apo mosveprimi eshte kryer ne mirebesim.

16.3 Ne rast te shkeljes se detyres dhe standarteve profesionale, sipas pikave 16.1. dhe 16.2 te ketij neni, Administratori eshte i detyruar te kompensoje Shoqerine per demet qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kaloje Shoqerise çdo fitim personal qe ka realizuar gjate kryerjes se ketyre veprimeve te parregullta. Ai ka barren e proves per te vertetuar se kryen detyrat e tij sipas standarteve. Kur shkelja eshte kryer nga me shume se nje Administrator ata per gjigjen ndaj Shoqerise ne menyre solidare.

16.4 Ne vecanti, Administratori/et eshte i/ jane te detyruar te demshperbleje/ne Shoqerine per demet, ne qofte se ne kundershtim me Ligjin per Shoqerite kryen veprimet e me poshtme:

- a. i kthen Ortakut/eve kontributet;
- b. i paguan interesa apo dividente Ortakut/eve;
- c. shperndarjen e aseteve te Shoqerise;
- d. lejon qe Shoqeria te vazhdoje aktivitetin e saj kur duhet parashikuar qe ajo nuk do te kete mundesi te paguaje borxhet e saj;
- e. te jape hua/borxhe.

Neni 17 **Shperndarja e Fitimeve**

17.1 Ortaket kane te drejten e perfitimit prej shperndarjes se fitimi te deklaruar te Shoqerise bazuar ne bilancin e Shoqerise te miratuar nga Asambleja e Pergjithshme.

17.2 Fitimi i Shoqerise percaktohet ne baze te bilancit te aprovar nga Asambleja e Pergjithshme. Shperndarja e fitimit do te caktohet nga Asambleja e Pergjithshme ne perputhje me Statutin, marreveshjen e Ortakeve dhe me ligjet e zbatueshme.

17.3 Nga fitimet vjetore krijohet nje fond rezerve ne perputhje me kushtet e legjislacionit Shqiptar per krijimin e fondeve rezerve te detyrueshem.

17.4 Shoqeria mund te shperndaje fitimet tek Ortaket vetem nese pas kesaj shperndarjeje:

- a. asetet e Shoqerise do te mbulojne plotesisht detyrimet e kesaj te fundit,
- b. Shoqeria ka aktive likuide te mjaftueshme per te shlyer detyrimet qe behen te kerkueshme brenda 12 muajve te ardheshem.

17.5 Administratori/et leshjon/jne nje certifikate te aftesise paguese, e cila konfirmon shprehimisht se shperndarja e propozuar e dividenteve permbush kerkesat e pikes 18.4 me siper. Ndersa kur gjendja e Shoqerise tregon se shperndarja e porpozuar e dividenteve nuk i permbuish keto kritere Administratori/et nuk e leshon/jne kete certifikate.

17.6 Administratori/et eshte/ jane perjegjes ndaj Shoqerise ne lidhje me vertetesine e Certifikates se aftesise paguese.

17.7 Sipas nenit 78 te Ligjit per Shoqerite, Ortaket dhe Administratori/et kane perjegjesi per shperndarjet te cilat bien ne kundershtim me dispozitat e Ligjit per Shoqerite Tregtare.

Neni 18

Dispozita te Ndryshme

18.1 Ky Statut mund te ndryshohet ose te zevendesohet me nje tjeter vetem me vendim te Asamblese se Pergjithshme.

18.2 Riorganizimi, ndryshimi i formes ligjore apo prishja e Shoqerise do te behet ne perputhje me dispozitat e Ligjit per Shoqerite.

18.3 Ortaket dhe Administratori/et do te veprojne me parimet e Ligjit per Shoqerite dhe ne vecanti ne perputhje me dispozitat e pjeses se pare, kapitulli 4 te Ligjit Per Shoqerite.

18.4 Personat te cilet jane perfshire ne krime te kryera gjate detyres se tyre ne Shoperi sipas nenit 163 deri 170 pika a) e Kodit Penal nuk mund te kryejne funksionet e perfaqesuesit ligjor, administratorit dhe te perfaqesuesit te shoqerise per nje periudhe prej 5 vjetesh nga kryerja e denimit.


18.5 Shoqueria duhet te perfshije ne raportin e saj vjetor nje pasqyre koherente dhe pershkruese, e cila permban pikat kyce te rregullave per drejtimin e Shoquerise dhe praktikave qe aplikon ne perputhje me Ligjin per Shoqerite.

18.6 Asambleja e Pergjithshme me propozimin e Administratorit/eve, mund te vendosi/in per krijimin e nje fondi rezerve per te permbushur te papriturat e Shoquerise ose per barazimin e fitimeve ose per mbajtjen e çdo pasurie te Shoquerise, ose per çdo qellim tjeter qe ortaku konsideron ne interes te Shoquerise.

18.7 Te gjitha çeshtjet qe nuk jane rregulluar shprehimisht ne kete Statut, i nenshtrohen rregullimit nga dispozitat e Ligjit per Shoqerite.

**ORTAKU I VETEM I SHOQERISE
" Bio Alpina " SHPK**

Irgent Myftaraj



A handwritten signature in blue ink, consisting of the name "Irgent Myftaraj" written twice, once above a horizontal line and once below it, with a large, stylized, sweeping flourish underneath.